VENDIM
Nr. 198, datë 4.4.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 135, DATË 6.3.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE TË KËRKESËS, TË RREGULLAVE TË KRYERJES SË VERIFIKIMEVE DHE KONTROLLEVE TË NEVOJSHME PËR FITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE KUR REPUBLIKA E SHQIPËRISË KA INTERES KOMBËTAR, APO INTERES NË FUSHËN E ARSIMIT, SHKENCËS, ARTIT, KULTURËS DHE SPORTIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe të ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 135, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave të kërkesës, të rregullave të kryerjes së verifikimeve dhe kontrolleve të nevojshme për fitimin e shtetësisë shqiptare kur Republika e Shqipërisë ka interes kombëtar, apo interes në fushën e arsimit, shkencës, artit, kulturës dhe sportit", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun II bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Ka mbushur moshën 18 vjeç dhe ka zotësi për të vepruar ose në rast se nuk ka mbushur këtë moshë, shtetësia shqiptare mund të fitohet vetëm me pëlqimin e të dy prindërve ose kujdestarit ligjor, si dhe të fëmijës që ka moshën 14–18 vjeç.".

b) Pika 2 shfuqizohet.

2. Në kreun IV bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

a) Shkronja "a", e pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) kërkesë individuale për fitimin e shtetësisë shqiptare drejtuar AHPVSH-së, sipas formatit të përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas rasteve të mëposhtme:

i. Kur kërkuesi është mbi 18 vjeç, kërkesa nënshkruhet personalisht nga kërkuesi.

ii. Kur kërkuesi është 14–18 vjeç, kërkesa bëhet nga kërkuesi dhe krahas saj depozitohet deklaratë noteriale ose dokumenti i barasvlershëm ku shprehet pëlqimi i të dy prindërve ose kujdestarit ligjor.

iii. Kur kërkuesi është nën 14 vjeç, kërkesa nënshkruhet nga të dy prindërit ose kujdestari ligjor.".

b) Në shkronjën "f", të pikës 1, pas fjalëve ".. nga personalitete të fushës ..." shtohen "... ose rekomandim nga titullari i institucionit arsimor apo shkencor ...".

c) Pas pikës 4 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

"5. Ministria përgjegjëse për vlerësimin e kontributit të shtetasit të huaj miraton rregulla të hollësishme lidhur me përcaktimin e kritereve specifike shtesë dhe procedurave të brendshme të trajtimit të kërkesave, që ndihmojnë në evidentimin e kontributit me interes kombëtar për shtetin shqiptar, për të cilin mund të fitohet shtetësia shqiptare.".

3. Në shkronjën "c", të pikës 3, të kreut V, togfjalëshi "... 7 (shtatë) ditëve ..." zëvendësohet me "... 10 (dhjetë) ditëve ...".

4. Në aneksin 1, në ndarjen "Informacion i përgjithshëm", në nënndarjen që parashikon se kur pranohet formulari, pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Është plotësuar nga vetë kërkuesi kur ai është mbi 14 vjeç ose nga prindërit ose kujdestari ligjor për kërkuesin, kur ai është nën këtë moshë.".

II. Ngarkohen ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, ministri përgjegjës për arsimin dhe sportin, ministri përgjegjës për kulturën dhe Agjencia për Hartimin e Programeve të Veçanta të Shtetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku